

AKT- THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“GJIKA GROUP”shpk

Ne Durres, sot me date, 09/01/2024 (dymije e njezet e kater) me cilësinë e “ Ortakeve themelues”

- **Z. Ervis Gjika** , lindur Miredit me 05.02.2000 identifikuar me ID nr 033578156 me NID K00205063P e vlefshem deri me date 24.01.2028 madhor,dhe me zotesi juridike dhe per te vepruar.

Kerkoj redaktimin e ketij Akt Themelimi, nepermjet te cilit deklaroje se me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ligjin nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne ate Doganor,Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, “ **GJIKA GROUP** ”shpk

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “GJIKA GROUP”shpk

Eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKR, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria “**GJIKA GROUP**”shpk, eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga **Z. Ervis Gjika** i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e rregjistruar te Shoqerise.

Neni 3

Selia



Shoqëria e ka selin në: **Autostrada Tirane Durres, object me numer pasurie 1/18 kati i dyte, zona kadastrale 8515 , Shkozet Durres**

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filial, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së ortakëve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Tregti dhe qeradhenie të pajisjeve audiovizuale , shërbime të ndryshme audiovizuale, DJ, ledwall, stage , shërbim fonie, dekore , organizim eventesh .

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestare i shoqërisë është 100 000 (një qind mijë) lekë,
Pjesëmarrja themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- 1- Ortaku themelues Z. **Ervis Gjika** : zotues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 leke, që përbënë 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë

Kapitali themeltar është i nënshkruar plotësisht nga ortakët themelues në masën 100%
Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme .
Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të lujtshme / të palujtshme apo të drejta)
Ortakët përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrajt të tretëve deri në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë ;

Neni 7

Transferimi i kapitalit



Kuota e kapitalit te nje shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Assambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise. Assambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statute duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Assambleja e ortakeve vendos per çeshtje si :

- a) Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) Percaktimin e shperblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga Assambleja e ortakeve regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per :



- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim , pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqerise "**GJIK** GROUP "shpk, caktohet, Z. **Ervis Gjika** , i cili emerohet per nje afat 5 vjeçar me te drejte ripertesitje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Assambleja e ortakeve te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregetare, te vednosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesoje shoqerine tregetare;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) Pergatise dhe nenshkruaj bilanci vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpendarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim
- e) Krijoi nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryej regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligjin per QKR.
- g) Raportoi perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregetare. Administratori eshte i detyruar te therrase ne mbledhjen e asamblese ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqërisë nuk I mbulojnë detyrimet e kerkueshme Brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria , brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj,propozon te bleje nga nje ortak pasuri,qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetave te shoqerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratoret , si se bashku edhe vecas njeri tjetrit, kane te drejt te kryejn te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtzakonshem. Administratoret e perfaqesojne Shoqerine perpara

te gjithë personave fizike e juridike, publike dhe /ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratoret kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te Shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakeve te Shoqerise.

Administratoret angazhojn Shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk mer persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e Shoqerise ose per te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti Financiar I Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht , viti I pare Financiar fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne QKR dhe mbyllet ne 31 dhjetor

Neni 12

Shperndarja ose prishja e Shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b) me vendim te ortakeve themelues
- c) me hapjen e procedurave te falimentimi
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 , date 3.5.2007 "Per Qendren Kombtare te Regjistrimit"
- e) me vendim te Gjykates

Ne kete rast Asambleja merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te Shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " shoqeri ne likuidim e siper"

Neni 13

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacioneve shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjiit "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise

Neni 14

Dispozita perfundimtare



Ky akt themelimi u redaktua ne 4 (kater) ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti I mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen e tij origjinale .

ORTAKET THEMELUES

Z. Ervis Gjika

ERVIS

GJIKHA

